

PROTOKOLL
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
DHE LIRIVE THEMELORE, AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR 11

Paris, 20. III. 1952

Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998.

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës,

Të vendosura që të marrin masa për të siguruar zbatimin kolektiv të disa të drejtave dhe lirive të tjera nga ato të përfshira në Seksionin I të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim e referuar si “Konventa”),

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera,.

Neni 2
E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Neni 3
E drejta për zgjedhje të lira

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Neni 4¹
Zbatimi territorial

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, në momentin e nënshkrimit ose të ratifikimit të këtij Protokolli ose në çdo moment tjetër të mëvonshëm, mund t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës një deklaratë, ku cakton masën në të cilën ajo merr përsipër të zbatojë dispozitat e këtij Protokolli në territoret e përmendura në deklaratën në fjalë, marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ajo siguron.

¹ Teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që ka komunikuar një deklaratë në bazë të paragrafit të mësipërm, mund të komunikojë herë pas here një deklaratë të mëtejshme që ndryshon përmbajtjen e çdo deklarate të mëparshme ose që i jep fund zbatimit të dispozitave të këtij Protokolli mbi çdo territor.

Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen, do të konsiderohet të jetë bërë në përputhje me paragrafin (1) të nenit 56 të Konventës.

Neni 5

Marrëdhënia me Konventën

Palët e Larta Kontraktuese do t'i konsiderojnë nenet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij Protokolli si nene shtesë të Konventës dhe për pasojë do të zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 6

Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim për anëtarët e Këshillit të Evropës, nënshkrues të Konventës; ai do të ratifikohet njëkohësisht me Konventën ose pas ratifikimit të saj. Ai do të hyjë në fuqi pas depozitimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit. Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Protokollin do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit.

Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili do t'u bëjë të njohur të gjithë Anëtarëve emrat e atyre që e kanë ratifikuar.

Bërë në Paris, më 20 mars 1952, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilës Qeveri nënshkruese.